

KOMUNIKATË PËR TË GJITHË MEDIAT VIZIVE, TË SHKRUAR DHE DIXHITALE SHQIPTARE DHE NDËRKOMBËTARE

THIRRJE DREJTUAR QEVERISË SHQIPTARE: URGJENTISHT LIRONI NGA PENGMARRJA QIPRIOTE FËMIJËN SHQIPTARE ELEFThERIA DHE KTHEJANI NËNËS SË SAJ !


Catania-Itali, më 15.01.2021



Eleftheria me nënën e saj përpara rrëmbimit




Tre vite pas rrëmbimit me babain biologjik -Qipro



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia Tirane
Njësia administrative Njësia Administrative Nr. 4
Zyra e Gjendjes Civile 376

000942201



Datë: 24.01.2021

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:



Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Terezina Gjoni	Zef	Shaqe	F	Kryefamiljari	28-11-1951	Ue divorcuar	Tirane	Shqiptare	F16128077W
2.	Dincra Neçi	Vangjel	Terezina	F	E bija	03-06-1980	Boqar	Berat	Shqiptare	I05603049N
3.	Eleftheria Eleftheriou	Nikolas	Dinora	F	Mbesa	26-10-2011	Boqar	Stravolas Lefkosa, Qipro	Shqiptare	L16026075N
4.										
5.										
6.										
7.										
8.										
9.										
10.										

Kjo certifikatë lëshohet për

Dokument

Nëpunësi i Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vula me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Direjtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)

Faqja 1 nga 1

Certifikatë Familjare nxjerrë nga Sistemi online i Qeverisë Shqiptare e-Albania që dëshmon shtetësinë shqiptare të Eleftheria-s banore e përhershme në Shqipëri në të njëjtën përbërje familjare me të ëmën Dinora Neçi nën kujdestarinë e saj ekskluzive.

Me këtë **letër të hapur**, shkruesja znj. Dinora Neçi, e ëma e fëmijës së mitur Eleftheria 'Eleftheriou' shtetase shqiptare, në virtyt të detyrimeve ndërkombëtare në lidhje me lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, kërkon ndihmën e të gjithë mass-mediave dhe mediave dixhitale

DINORA NEÇI

Dinora Neçi

shqiptare dhe ndërkombëtare, që të mbështesin dhe t'i japin zë dhe forcë luftës së saj për lirin e fëmijës së saj nga pengmarrja qipriote, në mënyrë që të zgjohet ndërgjegja e autoriteteve kompetente shqiptare dhe atyre qipriote nga përgjumja letargjike 5-së vjeçare dhe ta kthejnë vajzën e vogël shqiptare tek nëna e saj, sa më shpejt të jetë e mundur.

Nevojitet një uragan mediatik në nivel ndërkombëtar për çështjen e këtyre dy shtetaseve shqiptare, që synon ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe të autoriteteve përgjegjëse shqiptare për t'i kushtuar vemendje dhe një kujdes të veçantë duke intensifikuar masat për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, në mënyrë që të mos ketë më viktima të marrjes së pengjeve shtetas shqiptarë nga mafia institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare.

* * *


Zonja Dinora Neçi, është një NËNË SHQIPTARE, miti i së cilës mban emblemën e mbijetesës dhe ku mallkimi i vuajtjes nuk vjen për shkaqe hyjnore por për shkaqe artificiale të gatuar nga dora e njeriut dhe të mbështetura nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare dhe, ku përpjekjet me mjete juridike, mediatike dhe solidariteti njerëzor, nuk kanë bërë të mundur deri tani të thyejnë digat e së keqes që fshihen pas emrit që mbështesin krimin, sikurse është **shtetasi grek-qipriot NIKOLAS ELEFThERIOU i datëlindjes 14.02.1983 lindur në Ormideia-Qipro dhe me Kartë Identiteti qipriote Nr.847695.**

Ky subjekt, që deri para dy vitesh ishte bashkëpronar me familjen e tij prindërore të fabrikës së produkteve të djathit ACHNAGAL në Qipro, aty ku dhe filloi mashtrimi i shfrytëzimit të kësaj nëne duke e bërë viktimë të një punësimi të paligjshëm, sot, është pronar i mega Kompanisë AEOFORIKI DYNAMI N.E LTD po në Qipro, një pozicion me riliev të lartë që e bën atë 'të paprekshëm' nga Drejtësia Shqiptare, nga Drejtësia Qipriote, dhe jo vetëm!

Por, qendresa vazhdon, pasi zemra e një Nëne mbështetet tek Drejtësia, e cila, deri tani, ka qënë një produkt toksik për të drejtën e saj për të rimarrë fëmijën e saj pranë vehtes, krim i cili, për nga mënyra se si ka manifestuar të keqen, analogjinë e tij e gjejmë vetëm në fantashkencë.

Fëmija e mitur Eleftheria 'Eleftheriou' e datëlindjes 26.10.2011 shtetase shqiptare, e cila, që nga lindja është nën kujdestarinë prindërore eskuzive të nënës, zonjës Dinora Neçi dhe banore e përhershme në Shqipëri, prej 9 vitesh (që nga lindja) mbahet peng në Qipro (pjesa greke) nga shtetasi greko-qipriot Nikolas Eleftheriou i cili, për hir të së vërtetës, nuk ka asnjë lloj të drejte ndaj së miturës. Kjo bazohet në faktin se, ky shtetas që është babai biologjik i fëmijës, nuk ka qënë asnjëherë bashkëshorti i zonjës Neçi pasi, martesë civile e kryer me mashtrim, me qëllim dhe me faj të rëndë në bashkëpunim me familjarët e tij dhe me funksionarë përgjegjës qipriotë kundër saj (duke përfutur nga fakti themelor që nuk njihet absolutisht gjuhën greke, as ligjet dhe aspak procedurat e martesës si dhe, nga mirëbesimi i saj mbi të gjitha tek Autoritetet përgjegjëse Qipriote) në Bashkinë e Aradippou në Larnaka; e kryer brenda tre ditëve 14.05.2010 – 17.05.2010 përmes një vize turistike qipriote dhe një certifikate lindje të saj shqiptare e datës 08.02.2005 e përkthyer nga Nikolas Eleftheriou në një zyrë përkthimesh në Nikosia (Qipro); pa certifikatat e nevojshme për lidhje martesë që lëshohen nga Zyra e Gjendjes Civile dhe pa shpallje martesë në Bashkitë përkatëse (Tiranë dhe Larnaka); pa Nulla Osta për Martesë dhe pa një leje qëndrimi qipriote;

DINORA NEÇI



përmes aktesh dhe certifikatash të falsifikuara në gjuhën greke të lëshuara nga Gjykata e Larnaka dhe nga Bashkia e Aradippou po në Larnaka si dhe përmes procedurash absolutisht të pavlefshme/të paligjshme, pa praninë e një përkthyesi zyrtar të gjuhës shqipe dhe pa firmosur në regjistrin e martesave: **ËSHTË MARTESË ABSOLUTISHT E PALIGJSHME / INEKZISTENTE!!!**


Çështja në fjalë, karakterizohet nga një historik i gjatë kriminal me veprime aktive të kundërligjshme dhe të dënueshme duke filluar pikërisht me martesën false/inegzistente qipriote.

Qiprioti Nikolas Eleftheriou pjesë e kësaj organizate kriminale, zgjodhi strategjinë e mashtrimit dhe joshjes për të përdorur në aktivitetin e tij kriminal, nënën e fëmijës, shtetasen shqiptare Dinora Neçi, ku ëndrrën për t'u bërë nënë dhe krijuar familje, ia serviri, si alibinë e tij për të arritur qëllimet e tij kriminale. Edhe kjo anë, ishte në vetvete e errët, pasi Eleftheriou nuk kishte si synim të bërit baba, por, shfrytëzimin e emrit të saj, për të realizuar pastrimin e parave të pista ose siç quhet ndryshe "Parajsa Fiskale" duke hapur një llogari bankare të paligjshme në emrin e saj në një bankë qipriote me justifikimin sipas tij se, nevojitej si GARANCI BANKARE për lëshimin e lejes së qëndrimit qipriot si 'bashkëshorte' e shtetasit qipriot, por që në të vërtetë, e përdori atë për interesat e tij kriminale; mbajtjen e qëllimshme klandestine në kuptim Ligjit të Emigracionit Qipriot, deri në mbylljen dhe izolimin (nënë dhe foshnje shqiptare) në tokën qipriote në formën e pengmarrjes në kuptimin penal, përmes statusit fals 'e martuar/e divorcuar' dhe një leje false qendrimi të përkohshme qipriote në kategorinë si 'vizitore-turiste 2-vjeçare, e martuar me shtetas qipriot dhe me të drejtë punësimi, lëshuar nga Departamenti i Emigracionit në Nikosia-Qipro; ushtrimin e dhunës së rëndë psikologjike dhe fizike; fallsifikimin e dokumentacionit për regjistrimin e saj dhe të vajzës në Qipro si dhe, aplikimin e fallsifikimit deri në ndërhyrje të atilla, duke prodhuar akte false gjyqësore dhe administrative qipriote dhe duke i paraqitur si rrethana të 'vërteta' për asgjësimin e çdo lloj ndikimi të saj të ligjshëm rreth fëmijës apo qëllimeve të errëta të këtij individi.

Zonjës Neçi, shpejt ëndrra e bukur e amësisë, iu kthye në armikun e saj më të egër, kjo pasi, Nikolas qiprioti, tentoi disa herë që të realizonte abortin e shtatzanisë, duke kryer veprime konkrete për këtë, nëpërmjet dërgimit të saj në klinikën private të një mjeke gjinekologe me origjinë ruse, në Nikosia dhe fallsifikimit të rezultatit të analizave rutin të shtatzanisë me vajzën e saj. Në këtë klinikë, mikpritja fillonte me dhunën psikologjike dhe vijonte me llahtarinë që të krijonin fetuset e fëmijëve të abortuar, të cilët qëndronin si zburim frymëzues për doktoreshën monstër e kanibaliste që ushqej me vdekjen, e cila, në bashkëpunim me qipriotin Nikolas Eleftheriou dhe me familjarët e tij, tentuan që edhe foshnja Eleftheria, të bëhej pjesë e vitrinës së holokaustit të saj monstruoz.

Nga tentativa për të realizuar abortin për këtë shtatzani, zonja Dinora, zgjohet nga letargjia e mirëbesimit të deriatëhershëm ndaj qipriotit. Vëren që tentakulat e krimit po e kërcënonin, duke e shtyrë atë për të marrë masa me ripërsëritjen e analizave laboratorike në dy klinika të ndryshme dhe, duke vërtetuar komplet të kundërtën e bashkëpunësorëve në këtë krim sikurse janë babai biologjik Nikolas Eleftheriou me familjarët e tij dhe doktoreshën ruse. Ata pretendonin me këmbëngulje se po të mos abortohej, sapo të vinte në jetë ky fëmijë, do të vdiste. E, kur tentativa e tyre dështoi me sukses dhe Nëna Dinora, arriti të lindë fëmijën e saj të bekuar Eleftheria, Nikolas Eleftheriou, i cili inskenoi martesën fallco qipriote, meqënëse nuk arriti dot të realizojë abortin, qëllimi i tij ishte t'i rrëmbente fëmijën.

DINORA NEÇI



Eleftheriou, bëri të mundur edhe njohjen e paligjshme të atësisë për këtë fëmijë, nëpërmjet vetëdeklarimit si babai biologjik me anë të mashtrimit dhe me fallsitet të plotë, pa dijeninë dhe pa konsensusin e nënës së fëmijës, zonjës Neçi. Nëpërmjet korrupsionit dhe bashkëpunimit kriminal me mjekët në Spitalin e Përgjithshëm “MAKARIOU” në Nikosia ku lindi fëmija në Qipro, arriti të kryejë veprime që i shërbyen paraqitjes së të dhënave të rreme dhe të fallsifikuara përpara funksionarit të Zyrës së Gjendjes Civile në Larnaka, duke realizuar regjistrimin e të porsalindurës me të dhëna që nuk i përgjigjeshin realitetit. Kështu, ky fallsifikator dhe mashtrues qipriot, për qëllimin e vetëm mizor, rrëmbimin e së porsalindurës shqiptare nga gjiri i nënës, pa dijeninë dhe pa konsensusin e nënës Dinora, regjistron të miturën me mbiemrin e tij ‘Eleftheriou’ dhe duke i dhënë si origjinë, atë të fshatit të tij të lindjes Achna, dhe, në të njëjtat rrethana kriminale arrin t’i sigurojë të miturës shqiptare edhe shtetësinë false qipriote, pasaportën dhe kartën e identitetit false qipriote.

Gjatë këtij kalvari të gjatë vuajtjesh, kjo nënë, demonstroi vazhdimisht çuditshmërinë e saj të plotë ndaj fakteve dhe për këtë arsye, ajo nuk kishte asnjë formë heshtjeje që synonte mos denoncimin e paligjshmërive të tilla, pasi zbuloi më vonë të vërtetën e hidhur: martesën inekzistente qipriote. Por, oficerët e Policisë Qipriote të Stacionit Ksilofagou, Ksilotimbou, Ammochostos, Larnaca dhe Nikosia, kurrë nuk i lejuan asaj të bënte kallzim penal në lidhje me këtë martesë fallco, as për lejen e qëndrimit false qipriote, as për Alien Card Registration mashtruese qipriote dhe as për të gjitha krimet e rënda të kryera kundër saj dhe fëmijës nga ana e Eleftheriou në bashkëpunim me familjarët e tij dhe funksionarë qipriotë. Gjatë këtyre viteve, ndaj tyre është ushtruar dhunë dhe keqtrajtime të vazhdueshme deri në kërcënime për jetën, tentativa vrasje dhe izolimin e nënës dhe foshnjës shqiptare (ndërkohë e sëmurë me pneumoni) në qelitë e nëndheshme të Gjykatës së Larnaka dhe në qelitë e Gjykatës Penale të Paralimni(Ammochostos) me qëllim, realizimin e rrëmbimit të fëmijës për t’ia dhënë qipriotit kriminel, babait biologjik.

Nikolas qiprioti, edhe pse i braktisi nënë dhe foshnje shtatë muajshe, vazhdonte t’i mbante nën diktatin e tij në një banesë, kontrata e qerasë të së cilës ishte e fallsifikuar dhe, ku mungonte çdo gjë, përveç brejtësve përreth, pa ujë dhe pa energji elektrike duke ndërprerë furnizimin e tyre përmes aktesh të fallsifikuara. Në këto kushte të rënda jetese, fëmija Eleftheria në ato kohë vetëm 14 muajshe, sëmuret rëndë me pneumoni dhe nuk dihet arsyeja, se përse, mjekët pediatër qipriotë e trajtuan të miturën shqiptare për 15 muaj radhazi me terapi të gabuar si ‘azmatike’ pa patur një diagnozë të tillë, duke vënë në rrezik të madh shendetin dhe jetën e saj. Fatkeqësisht, edhe pse të shumta thirrjet e dëshpëruara të kësaj nëne për ndihmë, as Policia e Shtetit, as Interpol Tirana dhe as Ambasada Shqiptare në Athinë, nuk bënë dot të mundur shpëtimin e këtyre dy shtetaseve shqiptare nga ferri qipriot.

E gjendur në kufijtë e mbijetesës dhe e braktisur edhe nga Autoritetet Përgjegjëse Shqiptare, kjo nënë shqiptare, për të shpëtuar jetën e saj dhe të vajzës, ia del të ‘arratiset’ nga vendi ku mbaheshin peng në Qipron greke, duke u kthyer sëbashku me vajzën në Shqipëri.

Tipike në këtë histori të frikshme qipriote është fakti se, kësaj vajzë të mitur shqiptare Eleftheria, në mënyrë çnjerëzore dhe të paprecedentë, i është mohuar nëna dhe po rritet ‘jetime’ me nënë gjallë.

Kjo situatë, ka bërë që e Drejta të degradojë deri në atë pikë sa Drejtësia të shndërrohet në kriminale duke bartur dhe shfaqur frikshëm kaq shumë utopizma të tillë klithës, të cilët kërcënojnë si tërmet gjendjen e lirisë dhe të drejtave të nënës dhe të fëmijës së mitur. E gjithë kjo situatë paligjshmërie paraqitet në formën e një grupi të strukturuar kriminal pjesë e një organizate kriminale me shtrirje në shumë Shtete Europiane duke bërë që, akoma sot e kësaj dite, fëmijës ti mohohet e drejta për të jetuar me nënën dhe nënës për të rritur fëmijën e saj.

Por, ajo që e lidh të shkuarën e saj me atë aktuale, është vazhdimi i drejtësisë së munguar, ku në kapitullin njerëzor e gjen vetëm në historikun e holokaustit. Nikolas qiprioti, hidhet në sulm, duke krijuar të gjithë infrastrukturën e nevojshme kriminale. Dhe, është e pabesueshme, se si kjo nënë dhe fëmija e saj, në posedim të fakteve dokumentuese që dëshmojnë haptazi se janë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore ndërkombëtare dhe pengmarrjes qipriote 4 vjeçare, nuk u morën në mbrojtje as nga autoritetet policore belge dhe as nga ato italiane. Në këto kushte, të përndjekura edhe nga funksionarë të këtyre dy shteteve të implikuar në çështje, nëna vendos bashkë me foshnjën të rikthehet në tokën amë, Shqipëri, me besimin dhe shpresën se, kësaj here, lutjet dhe thirrjet e saj për të mbrojtur fëmijën e saj nga përpjekjet kriminale të babait biologjik për ta vjedhur, do të dëgjoheshin nga ana e autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse shqiptare.

Por, ndodh krejt e kundërta!

Qiprioti në fjalë, me burimet e tij të gjithanshme arrin të zbulojë vendodhjen e nënës me fëmijën në Shqipëri dhe, avancon skenarin e tij kriminal, duke paraqitur përmes Ministrisë së Drejtësisë Qipriote dhe kjo e fundit asaj Shqiptare, akte të fallsifikuara të martesës qipriote në të vërtetë inegzistente, akte fallse gjyqësore dhe administrative qipriote me anë të së cilave kërkon kthimin e fëmijës së mitur shtetase shqiptare, në Qipro.

Fatkeqësisht, krimi i orkestruar sa në Qipro, në Belgjikë dhe Itali, është ulëritës për nga mënyra se si shkelet deri në përdhunim legjislacioni i brendshëm dhe ndërkombëtar kundër një nëne dhe fëmijës së saj shqiptare. Por, ajo që kalon çdo kufi të imagjinatës njerëzore është se, autoritetet përgjegjëse shqiptare, siç janë: Policia e Shtetit, Interpoli, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Krimeve të Rënda, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Istitucioni i Avokatit të Popullit, me veprimet dhe mos veprimet e tyre të kundërligjshme i bëjnë atentat Kushtetutës së vendit, ligjeve të brendshme dhe akteve normative ndërkombëtare duke mos i mbrojtur këto dy qenie të pafajshme, bashkëkombaset e tyre.

Ajo që është më e dhimbshme, është se, as Prokuroria dhe as Gjykata e Beratit nuk i mbrojtë këto dy bashkëqytetaret e tyre, por të gjithë së bashku i hapen rrugën krimit të organizuar qipriot duke u bërë ‘një’ me qëllimin e babait biologjik për t’i rrëmbyer fëmijën shqiptare – nënës së saj.

Kështu, përmes një ‘letër-kërkesë’ e ardhur nga Ministria e Drejtësisë së Qipros e përcjellë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë Shqiptare Gjykatës së Beratit, kjo e fundit, në kohë rekord, brenda 7 ditëve, nxjerr një ‘vendim’ absurd si nga forma dhe nga përmbajtja dhe që, me plotë gojën mund të konsiderohet i nxjerrë nën lajthitje apo nën efektin e lajthitjes, pa një kërkesë padi – që

është themeli i një proçesi gjyqësor civil – dhe pa një kërkesë padi nga ana e babait biologjik, duke dhunuar haptazi tërësinë e Rendit Juridik dhe të drejtën e mbrojtjes ligjore, nënës së fëmijës.

Megjithëse në rastin në fjalë, faktet dhe rrethanat për hapjen e një proçesi civil për zbatimin e nenit 3 të Konventës së Hagës **“Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”** nuk ekzistojnë pasi, përgjegjësia prindërore e fëmijës që ka lindur dhe mbetet pa martesën e prindërve i përket nënës, kjo Gjykatë, në këtë ‘vendim’ ka marrë si të mirëqena dhe të ligjshme aktet fallse gjyqësore dhe administrative qipriote madje, duke arritur deri në çmenduri saqë e cilësojnë nënën e fëmijës si ‘e martuar’ dhe ‘e divorcuar’ nga qiprioti monstër Nikolas Eleftheriou, kur është e provuar mosegzistenca e martesës qipriote. Gjithashtu, në këtë pseudo-vendim nuk rezultojnë asnjë informacion në lidhje me verifikimet dhe analizën e gjendjes sociale-ekonomike-psikologjike të nënës dhe të fëmijës, gjë që bie në kundërshtim të hapur me legjislacionin familjar të brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Në të, poashtu, mbetet i errët dhe tërësisht anonim destinacioni në Qipro ku do vendosej e mitura shqiptare, duke mos e cituar qëllimisht këtë fakt në asnjë paragraf të tij. Po ashtu, ka cënuar në mënyrë çnjerëzore të drejtën e komunikimit dhe vizitave Nënë-Fëmijë, madje, nuk egziston asnjë njoftim për komunikimin e tij, as citon të drejtën për ta ankimuar atë.

Nuk ka parë historia juridike e gjykimit të një çështjeje me elementë të pastër familjar, ku bëhet fjalë për interesin më të lartë të fëmijës së mitur, ky interes, të mos i nënshtrohet më parë një ekspertimi me ekspertë të fushës psikolog/punonjës social, për të vlerësuar raportin midis nënës dhe vajzës së mitur dhe interesin e saj për zhvillimin normal fizik dhe psikologjik.


Në mënyrë të paprecedentë, i ka zëvendësuar të gjitha këto parakushte verifikimi ligjor me thjesht një letër-kërkesë absurde e cila mbështetet në një mal dokumentash të fallsifikuar.

Gjykata Berat, ka vepruar në paligjshmëri absolute të plotë, pasi sot e kësaj dite, **NUK EGZISTON** një vendim gjyqësor shqiptar apo qipriot i cili të bëjë fjalë për ndarjen e nënës nga fëmija dhe që të ketë marrë fuqi në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet njohjes së tij. Nga ana tjetër, asnjë lloj martese nuk rezultojnë e regjistruar në gjendjen civile në Shqipëri midis zonjës Dinora Neçi dhe shtetasit qipriot Nikolas Eleftheriou dhe, mbi të gjitha, vajza e mitur dhe e ëma janë shtetase shqiptare. Ndërsa, nga Gjykata Berat, trajtohen gati-gati si persona pa shtetësi, duke arritur në konkluzionin e gabuar dhe utopik qëllimisht se, vendbanimi i përhershëm i vajzës së mitur Eleftheria është në Qipro dhe jo në Shqipëri kur fëmija, rezultojnë nga aktet e gjendjes civile shqiptare e regjistruar në të njëjtën përbërje familjare me të ëmën Dinora Neçi nën kujdestarinë e saj eskluzive.

Marshimi i vuajtjes së nënës shqiptare Dinora, në kërkim të mbrojtjes të së bijës Eleftheria, do të kalojë në sfidë të tjera çnjerëzore ku, krimi i organizuar arrin në mënyrë të pabesueshme deri në rikthimin e saj me forcë dhe paligjshmërisht në Qipro. Kjo ndodh pikërisht nëpërmjet Gjermanisë, ku, ajo, sëbashku me vajzën e saj të mitur dhe nënën e saj 64 vjeçare në ato kohë, drejtohet tek autoritetet kompetente për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare.

Mjerisht, në tokën gjermane e priste fati i hidhur sepse, pas izolimit (gjyshe, nënë dhe fëmijë) për 14 orë në qeli, barbarisht, ia rrëmbejnë dhunshëm fëmijën e saj që sapo kishte mbushur 4 vjeç,

DINORA NEÇI



me gjithë pasaportën e saj shqiptare me qëllim që të fshihnin gjurmët e shtetësisë së saj shqiptare. Asnjë urdhër ndalimi apo arresti, asnjë vendim gjyqësor, as avokat e as përkthyes dhe asnjë gjurmë të një psikologu apo punonjësi social.

Në vazhden e diskriminimit të hapur, nëna e fëmijës, zonja Dinora Neçi, trajtohet si një kriminele lufte nga funksionarët gjermanë dhe jo si një nënë e cila, nuk kërkonte asgjë më tepër se një të drejtë natyrore dhe të ligjshme sikurse është ajo për të rritur pranë vehtes dhe me dashuri fëmijën e saj të shtrenjtë, Eleftheria.

Ndaj kësaj nëne të re shqiptare, funksionarët gjermane nuk kursyen, përveç rrëmbimit të dhunshëm të fëmijës së mitur Eleftheria, t'i heqin asaj edhe lirinë pa i komunikuar asnjë akuzë, duke e izoluar për 4 muaj nëpër biruca të monitoruara me kamera (në stacionet policore të Hahn-Frankfurt dhe të Simmern, në burgjet e Wollstein dhe të Koblenz të Rajonit RheinLand-Pfalz) në pritje të shkatërrimit të saj mendor dhe fizik. Kjo, kishte si qëllim të vetëm, provokimin e kësaj nëne të re shqiptare deri në aktin e vetëflijimit, në mënyrë që, krimineli qipriot Nikolas, të realizonte porosinë e tij kriminale për të zhdukur njëherë e mirë, të gjithë gjurmët e krimit që fshiheshin në memorien e të dhunuarës, viktimës së krimit të organizuar ndërkombëtar, Zonjës Neçi.


Fatkeqësisht, sulmi i pandërprerë me qëllimin e asgjësimit të viktimës së dhunës dhe padrejtësisë ka vazhduar edhe më tej nga funksionarët gjermanë, duke mos i lejuar asaj asnjë kontakt me vajzën dhe të afërmit e tjerë që prej rrëmbimit të fëmijës, si dhe, duke kulmuar më tej me mohimin e paprecedentë në historinë moderne të njerëzimit, nëpërmjet aplikimit të gjenocidit të hapur ndaj të drejtës për t'u dëgjuar dhe përfaqësuar nga një avokat mbrojtës edhe për faktin se, nëna, ishte personi që kishte kallzuar policisë së burgut pengmarrjen e fëmijës së saj nga policat gjermanë.

Ndaj, në këto kushte, kjo nënë e re shqiptare, e vetëdijshme për pengmarrjen e saj dhe të së bijës, nuk kishte rrugë tjetër për të rimarrë lirinë e saj dhe të fëmijës përveç se, atë të grevës së urisë që bëri për 12 ditë, pa asnjë trajtim të detyrueshëm nga ambienti ku u mbajt e izoluar për 46 ditë.

Dhe kjo, është vetëm maja e ajsbergut, pasi, ndaj saj ushtrohet dhunë psikologjike e rëndë dhe as që bëhet fjalë që mbi veprimet e dhunshme të punonjësve të policisë së burgut të kishte një mjet monitorues, ku, vetë monitoruesit shefa, referuar pasivitetit të tyre në ndaljen e dhunës, tregojnë faktin se udhëzimi ishte që “Gjaku Blu” i Zonjës Neçi, duhej të shkonte në parametrat e falimentimit të rezistenës fizike dhe psikologjike, për të përfunduar në të ‘bekuarën vetvrasje’ të saj, si ‘mjet shfajsimi’ edhe për fajtorët por edhe si ‘mjet i perligjur moral’ për autorët e krimit të organizuar ndërkombëtar.

Ndërsa nëna e re shqiptare përballej me kushtet e grevës në një rrugë pa kthim, funksionarët gjermanë të burgut i kërkuan asaj në gjuhën angleze (gjuhë të cilën e kuptonte dhe e fliste) që të nënshkruante një dokument në gjuhën gjermane, gjuhë absolutisht e panjohur për të. Nëpërmjet këtij akti dokumentar, ata synonin të arrinin qëllimin e tyre kriminal, nënshkrimin e vetvrasjes prej saj, për ta konsideruar asgjësimin e kësaj nëne të re shqiptare si një ngjarje aksidentale dhe jo si një vrasje e orkestruar, për të varrosur kështu, përfundimisht, të vërtetën e holokaustit ndaj saj dhe fëmijës së saj shqiptar, Eleftheria.

DINORA NEÇI



E megjithatë, nëna heroinë, maratonën e vuajtjes ekstreme e përjeton në Qipro, ku krimi i organizuar me autorë avokatë, funksionarë të policisë dhe të Gjykatave si dhe të policisë së burgjeve të Qipros, bëhet më shumë se kurrë frikësues, tashmë, me dy objektiva kryesore: **Së pari**, favorizimin e pengmarrjes së fëmijës së mitur shqiptare duke e lënë në kthetrat e kriminelit qipriot Nikolas Eleftheriou dhe familjarëve të tij. **Së dyti**, mbajtjen peng tre (3) muaj të Nënës Shqiptare nëpër stacionet e policisë, qelive të gjykatave dhe burgjeve qipriote nën ushtrimin e dhunës dhe torturave të rënda fizike e psikologjike. Funksionarët qipriotë, u solidarizuan me pranimin e pengmarrjes dhe e trajtimit çnjerëzor të Nënës Shqiptare duke ia pohuar asaj se ‘kishin urdhër nga maja e Piramidës’ për të kryer ndaj saj misionin e ekzekutimit të të drejtave të saj, deri, në përcjelljen e fundit, ku, me vazhdimin e aplikimit të atyre torturave, pasoja, nuk do të vononte për ta prezantuar atë me parajsën para kohe.

Ajo që është drithëruese dhe tejkalon çdo imagjinatë njerëzore është se këtë QENIE, MISHËRIM I PASTËR I MIRËSISË, I JETËS, I PAQES DHE I PAFAJËSISË, fillimisht e sulmojnë, e rrahin egërsisht, pastaj e prangosin këmbë e duar dhe në mënyrë çnjerëzore e lidhin në një barrelë me shirita ngjyrë portokalli si të ishte një rrezik potencial global për mbarë njerëzimin. Për të vetmen arsye, sepse kjo NËNË SHQIPTARE, nuk pranonte të firmoste akte të shkruara në Greqisht (gjuhë të cilën e fliste por nuk dinte as ta shkruante dhe as ta lexonte) që nuk i përgjigjeshin realitetit të saj pasi, ajo ishte e vetëdijshme për pengmarrjen e saj dhe të fëmijës së saj shqiptar nga zyrtarët e inkriminuar qipriotë që po vepronin për llogari të familjes mafioze Eleftheriou dhe se nuk ishte e burgosur sipas ligjit.

Të gjitha këto monstruozitete kishin për qëllim shkatërrimin e egzistencës së saj qoftë mendore dhe fizike, për t’i krijuar paaftësi të atillë që, qenia e saj të mos shërbente më si provë për të rrëfyer krimin as nëpërmjet të folurës, as përmes shkrimit dhe as nëpërmjet shikimit. E në këtë periudhë, vuajtja i kthehet në forcë ndërsa mbijetesa kthehet në qëllim në vetvete, pasi me të, varej edhe shpëtimi i vajzës së mitur nga kthetrat e krimit.

Ndërsa të gjitha tentativat e tyre dështuan për ekzekutimin e saj në qelinë ku e mbanin të izoluar, familja mafioze qipriote Eleftheriou (pronarë të biznesit “ACHNAGAL”), zgjodhën një platformë tjetër hakmarrjeje ndaj simbolit të Nënës Heroinë, Dinora. Kjo familje mafioze ndërtoi alibinë e radhës, duke arritur deri aty sa të manipulojë edhe momentin më të shenjtë të jetës së fëmijës sa fetar dhe hyjnor, ku, ndërkohë që nëna e vajzës së mitur shqiptare Eleftheria mbahej peng, ata dëshmuuan edhe një herë mizorinë e tyre, injorimin e egzistencës së kësaj nëne, duke pagëzuar fëmijën e saj pa dijeninë dhe pa konsensusin e saj, në një kishë ortodokse në Qipro.

Kështu, familja Eleftheriou tregoi edhe këtu se është kaq anti Zot sa që, në vend të një vepre të bekuar sikurse duhet të ishte prezenca dhe dëshira për të qënë prezente nëna e fëmijës, ata, për të justifikuar këtë mungesë (të nënës), nëpërmjet fallsifikimit të të gjitha rrethanave që lidhen me padrejtësitë flagrante dhe të ashpra si ndaj nënës dhe fëmijës së mitur shqiptar, krijuan një sakrilegj të frikshëm përmes fallsifikimit edhe të ritit fetar.

Ofensiva e përndjekjes dhe e persekutimit nga kjo organizatë kriminale kalon në fazën ekzekutive të saj (fëmijën ia kishin marrë peng) për ti dhënë të shtyrën e fundit nënës shqiptare të

rezistencës ndaj holokaustit. Funkionarët e policisë qipriote të Departamentit të Imigracionit nuk hezituan të shpërdorojnë detyrën e tyre duke e trajtuar vendin e punës si mjet të realizimit të krimit. E kërcënojnë këtë nënë shqiptare në ligjëratë të drejtë: ‘E ke të kotë që kërkon leje qendrimi pasi kërkesa jote nuk do të pranohet, prandaj ose ik me vullnetin tënd nga Qipro ose do dali urdhër dëbimi ndaj teje. Mos këmbëngul, se do të kthejmë atje ku ishe (e mbajtur peng në qeli).’

Beteja e frikshme vazhdon.

Nikolas me botën e krimit nga pas, ka asfiksuar dhe vazhdon të asfiksojë me sukses deri tani përdorimin e mjeteve ligjore dhe mekanizmat shtetërorë për rikthimin e vajzës së mitur, nënës Dinora Neçi, madje duke ndaluar me postoblokun e paligjshmërisë edhe të drejtën që nëna të shoh në minimum vajzën e saj të mitur, për t’u ndierë nënë, për t’u ndierë prind, për t’u ndierë e barabartë si gjithë nënat në mbarë botën.

ËSHTË UNIVERSALISHT E NJOHUR SE NUK KA LIGJ QË NDALON TË DREJTËN E KOMUNIKIMIT NËNË DHE FËMIJË!

Por Shteti Shqiptar, prej vitesh në dijeni të holokaustit kundër nënës Dinora Neçi dhe fëmijës së saj Eleftheria Neçi (‘Eleftheriou’) shtetase shqiptare e cila, që nga lindja është nën kujdestarinë eskuzive të nënës dhe banore e përhershme në Republikën e Shqipërisë, ka treguar dhe vazhdon të tregojë një pasivitet total edhe ndaj pengmarrjes politike të së miturës shqiptare, përmes heshtjes së frikshme.

Shqiptarja e vogël Eleftheria u rrëmbye në mënyrën më makabre të paimagjinueshme dhe prej 5 vitesh mbahet peng në Qipro, pa ditur fatin e nënës së saj. Pa as edhe një telefonatë me njeriun e saj më të shtrejtë, ajo që i dha jetë, që e mbrojti dhe e rriti. Këtë lidhje thellësisht të ngushtë dhe ku mbretëronte një simbiozë e përsosur midis nënës dhe vajzës, e ndërpre në mënyrë barbare ata që duhej t’i mbronin këto dy qenie të pafajshme. Nga ana tjetër, autoritetet kompetente qipriote, të vetëdijshëm për çështjen në fjalë, janë informuar gjithashtu me fakte dhe prova të dokumentuara tronditëse të shërbyera nga nëna e fëmijës, zonja Neçi dhe, fakti i trishtuar që kjo e mitur shqiptare ende mbahet peng në Qipro, demonstroi skandalozisht dhe në dritën e diellit se autoritetet policore qipriote me veprimet dhe mosveprimet e tyre kundër ligjit tregojnë injorancë dhe neglizhencë të qëllimshme ndaj krimit të organizuar në një çështje kaq të ndjeshme.

E njëjta ‘politikë humane’ ndiqet edhe nga drejtori i “Shkollës Filllore Publike A” në Ormidia – Larnaka (Qipro). Ky kryemësues, pjesë e administratës publike qipriote, edhe pse i informuar nga nëna e fëmijës Zonja Neçi e cila, i ka dërguar me e-mail dhe fax faktet dhe provat dokumentuese të pakundërshtueshme që dëshmojnë pengmarrjen e fëmijës shqiptare Eleftheria në tokën qipriote, përmes telefonatës, i ka pohuar se e mitura shqiptare vazhdon klasën e tretë pranë këtij Instituti Shkollor por, pa asnjë justifikim të ligjshëm, ka refuzuar absolutisht që të kryhet një telefonatë midis nënës dhe fëmijës së saj.

Është aq sa e frikshme dhe e pabesueshme që, autoritetet kompetente të Shtetit Qipriot, që kanë detyrimin dhe përgjegjësinë ligjore, të garantojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, dhe ku ndjeshmëria njerëzore duhet të jetë akoma më e madhe kur bëhet fjalë për trafikimin e një fëmijë

të mitur, përballemi me funksionarë dhe zyrtarë qipriotë të cilët, në vend që t'i shërbejnë ligjit dhe drejtësisë për të parandaluar dhe për të luftuar krimin e organizuar, bashkëpunojnë si aleatët më besnikë të familjes mafioze qipriote Eleftheriou, pjesë e organizatës së mirëorganizuar dhe të mirëstrukturuar kriminale ndërkombëtare!

* * *

Arsyetimi ligjor në vijim, i bazuar në Legjislacionin Penal Shqiptar dhe Legjislacionin Penal Qipriot dhe në të Drejtën Penale Ndërkombëtare si dhe në prova të dokumentuara, në lidhje me konsumimin e pesë (5) prej veprave të shumta të rënda penale kryer kundër nënës dhe fëmijës së saj dëshmon se, **Zonja Dinora Neçi dhe fëmija e saj e mitur Eleftheria 'Eleftheriou' shtetase shqiptare, janë viktimat të pengmarrjes dhe të trafikimit të qenieve njerëzore të krimit të organizuar ndërkombëtar gjeneruar nga Qipro (greke), atje ku, kjo fëmijë, pasi u rrëmbye në tokën gjermane më 10 nëntor 2015 nga një akt terrorist i shtatë (7) policëve gjermanë, prej 5 vitesh mbahet peng pa asnjë kontakt me Nënëen e saj.**

1. Martesa false/inekzistente qipriote.

Martesa civile në Qipro është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore të neneve 4, 5, 6, 7, 8, 9(1), 10(1) të ligjit qipriot **“Ligji për Martesat” nr. 104 / 2003** http://www.cylaw.org/nomoi/enop/non-ind/2003_1_104/full.html që përcaktojnë procedurat e martesës të shtetasve qipriotë me shtetasit e vendeve të treta, dispozita të publikuara edhe në faqen zyrtare web të Ministrisë së Brendshme të Qipros – Departamenti i Regjistrimit të Popullsisë dhe të Imigracionit <http://www.moi.gov.cy/moi/CRMD/crmd.nsf/All/12A0C4FE1849410AC2257D1E001EE8E3?OpenDocument> që bie gjithashtu në kundërshtim të hapur edhe me ligjin shqiptar **Ligji Nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”** përkatësisht me nenet 46, 47, 48, 49, 50 dhe me **Ligjin Nr. 9062 datë 08.05.2003 KODI I FAMILJES.**

Dokumentet e mëposhtme të znj. Dinora Neçi:

- a) Çertifikatë Lindje dhe Çertifikatë Personale shqiptare, lëshuar më 03.07.2017 nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë-Shqipëri me përkthim të noterizuar në gjuhën italiane dhe legalizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë (**dok. nr.1-10**);
- b) Çertifikatë Lindje për Lidhje Martese me bashkëshortin e saj, shtetas italian, lëshuar më 19.01.2018 nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë-Shqipëri (**dok. 11**);
- c) Çertifikatë Shpallje Martese nr. 38 së znj. Neçi dhe bashkëshortit të saj, lëshuar më 19.01.2018 nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë-Shqipëri (**dok. 12**);
- d) Nulla Osta për Martesë me nr. Regj. 107798, lëshuar më 29.03.2018 nga Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë në Milano/Itali dhe e legalizuar nga Prefektura e Catania, Siçili (**dok. 13, 14**);
- e) Çertifikatë Shpallje Martese nr. 1080 midis znj. Neçi dhe bashkëshortit të saj, lëshuar më 30.08.2018 nga Zyra e Gjendjes Civile - Bashkia Mascali, (CT) Itali (**dok. 15**);

f) Ekstrakt i Aktit të Martesës së znj. Dinora me bashkëshortin e saj shtetas italian, lëshuar më 09.10.2018 nga Bashkia Mascali (CT) Siçili/Itali (**dok. 16**), vërtetojnë statusin e saj civil BEQARE para kryerjes së martesës me bashkëshortin e saj shtetas italian, fakt ky që dëshmon se, asnjë lloj shpallje apo lidhje martese nuk rezulton e regjistruar në Gjendjen Civile në Shqipëri midis znj. Neçi dhe shtetasit qipriot Nikolas Eleftheriou. Pra, është e provuar mosegzistenca e martesës civile qipriote.

Flasin vetë gazetatat qipriote për **fenomenin karcinomë të martesave false në Qipro** (ose “*martesa virtuale*” që ka kuptimin që i është dhënë nga ligji qipriot “Për të Huajt dhe Imigracionin”), ku shtetasja shqiptare znj. Dinora Neçi ra viktimë, disa prej të cilave janë si më poshtë vijon:

1. <https://www.alltogethercy.com/chiliades-oi-eikonikoi-gamoi-stin-kypro/>
2. https://www.ekirikas.com/archive_cyprus_general_news/arthro/stigmatizetai_h_kypros_os_meros_tesis_eikonikon_politikon_gamon-88443/
3. <https://www.sigmalive.com/news/local/643140/eikonikoi-gamoi-sta-xnaria-ton-mesazonton-se-kypro-kai-roumania>
4. <https://www.sigmalive.com/news/local/591470/etsi-tha-ekane-ton-eikoniko-gamo-i-23xroni-sti-larnaka>
5. <https://www.philenews.com/koinonia/eidiseis/article/742939/emploki-kyproy-se-diethnes-kykloma-eikonikon-gmon>
6. <https://www.philenews.com/koinonia/eidiseis/article/631827>
7. <https://www.philenews.com/koinonia/eidiseis/article/774813>
8. <http://www.newsincyprus.com/greek//news/222261/ypes-sto-tmhma-metanasteyshs-h-megalyterh-ey8ynh-gia-toys-eikonikoys-gamoys>
9. <https://cyprustimes.com/xetyligetai-to-koyvari-gia-ti-nea-ypothesi-eikonikon-gamon-ypo-kratise-oi-dyo/>
10. <https://www.tothemaonline.com/Article/70478/aradipoy-hrewnotan-o-dhmos-me-plaketes-gamoy-apo-to-ergostasio-toy-dhmarhoy-k-eyaggelidh---ntokoymenta>
11. <https://politix.com.cy/politix-news/kypros/ypes-ragdaia-ayxise-eikonikon-gamon-3-600-se-dyo-chronia/>
12. <https://cyprustimes.com/nomoschedio-gia-antimetopise-eikonikon-gamon-enopion-tis-voylis/>
13. <https://cyprustimes.com/etaxe-se-33xroni-eikoniko-gamo-kai-tsepose-chiliades-yo-4imeri-kratise-o-23chronos/>
14. <https://cyprustimes.com/treis-syllipseis-gia-eikonikoys-gamoys-kai-plasta-eggrafa-martyria-enantion-27-prosopon/>
15. <https://www.newsbomb.com.cy/kypros/story/778208/o-eikonikos-gamos-kai-oi-ekviasmoi-piso-apo-ti-dolofonia-toy-andrei>
16. <https://www.newsbomb.com.cy/kypros/larnaka/story/741228/eikonikos-gamos-me-antitimo-1500-eyro>
17. <https://www.newsbomb.com.cy/kypros/larnaka/story/670910/ypo-kratise-6-prosopa-gia-ypothesi-tesis-eikonikon-gamon>
18. <https://www.newsbomb.com.cy/kypros/story/669428/exaimeri-kratise-trion-andron-apo-ti-mpagklantes-gia-tesei-eikonikon-gamon-me-roymanes>

19. <https://www.newsbomb.com.cy/kypros/story/664772/apotelesmatika-metra-gia-pataxi-ton-eikonikon-gamon-tha-proothisei-i-kyvernisi>
20. <https://www.newsbomb.com.cy/kypros/larnaka/story/664218/exaimerikratisi-tessaron-andron-gia-ypotheseis-telesis-eikonikon-gamon>
21. <https://www.newsbomb.com.cy/kypros/larnaka/story/664191/xeiropedes-se-4-antres-gia-tesli-eikonikon-gamon-stin-kypro-kataziteitai-mia-gynaika>
22. <https://www.newsbomb.com.cy/kypros/story/648192/emporia-prosopon-eikonikoi-gamoi-kai-soreia-kakoyrgimaton-oi-katigories-gia-27xrono-syllifthenta>
23. <https://www.newsbomb.com.cy/kypros/story/643555/syllipsi-tessaron-atomon-gia-emporia-enilikon>
24. <https://www.newsbomb.com.cy/kypros/leykwsia/story/643449/xeiropedes-se-dyo-atoma-gia-ypotheseis-telesis-eikonikon-gamon>
25. <https://www.newsbomb.com.cy/kypros/story/642352/22xroni-irthe-stin-kypro-gia-na-kanei-eikoniko-gamo-eno-einai-pantremeni>
26. <https://www.philenews.com/koinonia/eidiseis/article/870341>
27. <https://www.philenews.com/koinonia/eidiseis/article/727554/eikonikoi-gmoi-pantrepse-akoma-kai-ti-symbia-toy-25chronos>
28. <https://www.philenews.com/koinonia/eidiseis/article/726657/kanonize-eikonikoys-gmoys-kratoyse-18chroni-para-ti-thelisi-tis>
29. <https://www.philenews.com/koinonia/eidiseis/article/742939/emploki-kyproy-se-diethnes-kykloma-eikonikon-gmon>
30. <https://www.philenews.com/koinonia/eidiseis/article/659611/eikonikoi-gmoi-tora-kai-me-symfono-symbiosis>
31. <https://www.philenews.com/koinonia/eidiseis/article/655484/sto-keli-21chronos-ga-ypothesi-telesis-eikonikoy-gmoy>
32. <https://www.philenews.com/koinonia/eidiseis/article/651761/ekmetallefsi-nearis-ga-eikoniko-gmo>
33. <https://24h.com.cy/2020/09/eikonikoi-gamoi-ton-mazepsan-stin-larnaka/>
34. <https://www.alphanews.live/cyprus/noyris-ston-alpha-leitoyrgos-dimarheioy-teloyse-eikonikoys-gamoys-binteo>

Artikujt e mëposhtëm flasin specifikisht, për martesat virtuale si një fenomen i hasur shpesh pikërisht në Bashkinë e Aradippou në Larnaka, aty ku Nikolas Eleftheriou me bashkëpunëtorët e tij kryen me mashtrim martesën falso kundër znj. Neçi, shtetase shqiptare respektuese e ligjeve dhe e Institucioneve Qipriote:

35. <https://politiss.com.cy/politis-news/kypros/mastiga-oi-eikonikoi-gamoi-mia-apli-klopi-anedeixe-to-provlima/>
36. <https://www.sigmalive.com/news/local/591470/etsi-tha-ekane-ton-eikoniko-gamo-i-23xroni-sti-larnaka>
37. http://voulinet-ipourgia-kipros.blogspot.com/2017/01/blog-post_59.html

Artikuj të tjerë të gazetave qipriote flasin për denoncimet e paraqitura nga ambasadat e Letonisë, Portugalisë dhe Rumanisë drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Qipros në lidhje me martesat virtuale që bëhen në Bashkinë e Aradippou në Larnaka:

38. <http://riknews.com.cy/index.php/news/kinonia/item/93351-ekonomikoi-gamoi-parapona-portogalias-roumanias>
39. <https://www.alphanews.live/cyprus/kataggellei-eikonikoys-gamoys-stin-aradippoy-i-kybernisi-tis-letonias-binteo>

Në rastin në fjalë, jemi përpara faktit të një **“martese inekzistente”** sipas nenit 19 pika (1) gërma (a dhe c) të “Ligji për Martesat” nr. 104 / 2003 dhe veprimeve dhe mosveprimeve që përbëjnë elementë të disa veprave të rënda penale të parashikuara nga ky ligj në nenet si më poshtë:

Neni 33. **“Martesa në kundërshtim me këtë ligj”**: *“Një Oficer Martesash, i cili kryen një martesë duke e ditur se ndonjë dispozitë e këtij Ligji nuk është respektuar, kryen një veprë penale, e dënueshme me burgim për dy vjet ose me gjobë deri në dy mijë euro ose të dyja dënimet”;*

Neni 34. **“Deklarata të rreme”**: *“Çdo person i cili qëllimisht bën ndonjë dëshmi të rremë në ndonjë deklaratë, çertifikatë ose dokument tjetër të kërkuar nga ky Ligj për t'u bërë ose lëshuar, kryen një veprë penale dhe i nënshtrohet burgimit për një periudhë që nuk i kalon dy vjet ose me gjobë deri në dy mijë euro ose të dyja dënimet”;*

Neni 35. **“Falsifikimi i çertifikatës”**: *“Një person i cili falsifikon ndonjë çertifikatë ose vërtetim të përmendur në këtë ligj ose përdor me vetëdije një dokument të falsifikuar ose me vetëdije pranon ose qarkullon një çertifikatë ose vërtetim të tillë të falsifikuar, është fajtor për një veprë penale dhe, nëse dënohet, i nënshtrohet burgim që nuk i kalon shtatë (7) vjet ose gjobë që nuk i kalon njëzet mijë euro (20,000 €) ose të dyja dënimet.”*

Sipas ligji qipriot “Për të Huajt dhe Emigracioni” (**KAPITULLI 105**) http://www.cylaw.org/nomoi/enop/non-ind/0_105/full.html figura e veprës penale **“martesa virtuale”** dënohet sipas nenit 7D të tij ku thuhet: *“Një i huaj ose shtetas i Republikës i cili ka kryer një martesë fiktive ose në ndonjë mënyrë ka kontribuar në kryerjen e një martese të tillë kryen një veprë të dënueshme me burgim deri në pesë (5) vjet ose me gjobë deri në njëzet mijë euro (20,000 €) ose të dyja dënimet.”*

Kodi Penal i Qipros (**KAPITULLI 154**) http://www.cylaw.org/nomoi/enop/non-ind/0_154/full.html për elementët e veprës penale të martesës mashtruese parashikon dënimin sipas neneve më poshtë:

Neni 178. **“Pretendim mashtrues i martesës”**: *“Kushdo që me dashje dhe me mashtrim nxit një grua e cila nuk është e martuar ligjërisht me të, me besimin se ajo është martuar ligjërisht me të dhe nën gjendjen e një besimi të tillë, të bashkëjetojë ose të kryejë marrëdhënie me të, është fajtor për këtë krim dhe i nënshtrohet burgimit dhjetë vjet.”*

Neni 180. **“Ceremoni martese mashtruese”**: *“Kushdo që në mënyrë të pandershme ose me mashtrim e paraqet veten në një ceremoni martese, ndërsa e di që kjo ceremoni nuk e bën atë të martuar ligjërish, është fajtor për këtë krim dhe dënohet me pesë vjet burgim.”*

2. Tentativa e abortit.

Për veprën penale **“Tenative aborti”** e kryer nga babai biologjik i fëmijës në bashkëpunim me familjarët e tij dhe gjinekologen ruse, neni 167 i Kodi Penal Qipriot (Kap. 154) parashikon se: *“Kushdo që, për të shkaktuar abort të ndonjë gruaje, qoftë shtatzënë apo jo, administron në mënyrë të paligjshme tek ajo ose e bën atë të marrë helm ose send tjetër të dëmshëm ose përdor dhunë të çfarëdo lloji, ose ndonjë mjet tjetër, është fajtor për këtë krim dhe dënohet me katërbëdhjetë vjet burgim.”* ndërsa, vepra penale **“Furnizimi me ilaçe ose instrumente për abort”** edhe kjo e konsumuar prej tyre, ndëshkohet sipas nenit 169 i këtij Kodi, ku shprehimisht thuhet: *“Kush pranon ose furnizon në mënyrë të paligjshme diçka, që e di se synohet të përdoret në mënyrë të paligjshme për të shkaktuar abort te një grua që është shtatzënë ose jo, është fajtor për këtë krim dhe i nënshtrohet tre vjet burgim.”* Faktet, provat e dokumentuara si dhe dëshmitë e nënave të tjera dëshmojnë aktivitetin kriminal me embrionat fetus të vdekur që kryen gjinekologia me origjinë ruse në Nikosia, Qipro.

Vepra penale **“Tentativë aborti”** sipas Kodit Penal Shqiptar, në kuptim të neneve 22, 23, 25, 26, 27 dhe 93, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

3. Leja false e qendrimit qipriot

Dokumenti qipriot ‘leje qendrimi e përkohshme, kategoria vizitore 2-vjeçare, e martuar me shtetas qipriot dhe me të drejtë punësimi, adresa e shtëpisë e njëjtë me adresën e punës’, lëshuar nga Departamenti i Emigracionit në Nikosia-Qipro dhe ‘Alien Registration Certificate si visitore-turiste’, lëshuar nga Zyra e Emigracionit të Paralimni, në Ammochostos, bien në kundërshtim të hapur me dispozitat e ligjit qipriot “Për të Huajt dhe Emigracionin” (Kapitulli 105) dhe Rregulloret “Për të Huajt dhe Emigracionin” të cilat përcaktojnë kriteret, dokumentet e nevojshme dhe procedurat për regjistrimin, lëshimin dhe rinovimin e lejes së qendrimit për shtetasit e vendeve të treta që janë bashkëshortë/familjarë të qytetarëve qipriotë, dispozita të cilat janë të publikuara edhe në faqen zyrtare web të Ministrisë së Brendshme të Qipros – Departamenti i Regjistrimit të Popullsisë dhe të Imigracionit:

<http://www.moi.gov.cy/moi/CRMD/crmd.nsf/All/D5F15BE1D20E8BBCC2257D6D004470FD?OpenDocument>

Në rastin në fjalë, vepra penale e manipulimit dhe fallsifikimit të lejes së qendrimit që nënkupton imigracion të paligjshëm dhe qëndrim i parregullt në territorin qipriot, sipas nenit 19 dhe nenit 19A të Ligjit qipriot “Për të Huajt dhe Emigraconin Kap. 105 http://www.cylaw.org/nomoi/enop/non-ind/0_105/full.html dënohet me burgim jo më shumë se tetë vjet ose me gjobë që nuk i kalon njëzet mijë euro ose me të dyja këto dënime.

4. Rrëmbimi/mbajtja peng e personit/trafikimi i qenieve njerëzore.

Mbajtja nënë dhe foshnje shqiptare për 4 vite (2010-2014) në tokën qipriote përmes mashtrimit, dhunës, forcës dhe veprimeve dhe mosveprimeve të tjera të paligjshme dhe të dënueshme, në kuptim të ligjit penal, kualifikohet si vepër penale **“pengmarrje personi”** parashikuar sipas nenit 1 të Konventës Ndërkombëtare të Nju Jorkut **“Kundër marrjes së pengjeve”** të 18 dhjetorit 1979 e ratifikuar nga Shqipëria më 22 nëntor 2001 me Ligjin Nr. 8837 dhe nga Qiproja më 28 dhjetor 1990 me ligjin nr. 244 (I) 1990, që parashikon se:

“1. Kryen krimin e marrjes peng sipas kësaj Konvente kushdo që merr posedimin e një personi (këtu e tutje referuar si "peng") ose ndryshe e mban atë dhe kërcënon ta vrasë, plagosë ose të vazhdojë ta mbajë në mënyrë që të detyrojë një palë të tretë, në veçanti një shtet, një organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare, një person fizik ose juridik ose një grup personash, të kryejë ndonjë veprim ose të përmbahet nga veprimi i saj në si kusht i qartë ose i nënkuptuar i lirimit të pengut. 2. Ai është po aq fajtor për një vepër penale sipas kësaj Konvente kushdo: a) që bën përpjekje për të kryer një veprim të marrjes së pengjeve, ose b) bëhet bashkëpunëtor i një personi që kryen ose përpiqet të kryejë një vepër të marrjes peng.”

Kodi Penal qipriot (Kap. 105) për figurën e veprës penale **“rrëmbim/pengmarrje personi”** neni 247 i tij parashikon se:

“Kushdo që, me forcë ose me ndonjë mjet mashtrues e motivon tjetrin të largohet nga një vend, konsiderohet të jetë rrëmbimi i personit të përmendur” ndërsa, neni 250 i tij për veprën penale **“Rrëmbimi ose mbajtja peng i një personi me qëllim të përmbajtjes së fshehtë dhe të padrejtë”** parashikon shprehimisht se:

“Kush rrëmben ose rrëmben një tjetër, me qëllim që të shkaktojë përmbajtjen e tij të fshehtë dhe të padrejtë, është fajtor për këtë krim dhe i nënshtrohet shtatë vjet burgim.”

Gjithashtu, nënë dhe fëmijë janë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore në Qipro, të shfrytëzuara për veprimtaritë kriminale të Nikolas Eleftheriou dhe bashkëpunëtorëve të tij zyrtarë dhe funksionarë qipriotë. Sipas ligjit qipriot **“Për Parandalimin dhe Luftën e Trafikimit dhe Shfrytëzimit të Personave dhe Mbrojtjen e Viktimave të vitit 2014 (60 (I) / 2014)”** http://www.cylaw.org/nomoi/enop/non-ind/2014_1_60/full.html neni 6 i tij për veprën penale **“Trafikimi i personave të rritur”** parashikon:

“Kush rekruton, punëson, transporton, lëviz, transferon, ushqen ose pranon një të rritur, strehon ose pret, shkëmben ose transferon kontroll ose edhe pushtet mbi atë person, me qëllim të shfrytëzimit të tij, përmes: (a) kërcënime, dhe / ose (b) përdorimi i forcës ose formave të tjera të detyrimit, dhe / ose (c) rrëmbim, dhe / ose (d) qëllimi ose mashtrimi, ose paramendimi, dhe / ose (e) abuzimi i pushtetit ose një pozitë e prekshme e një natyre të tillë që personi në fjalë nuk ka mundësi tjetër përveç se t'i nënshtrohet abuzimit, dhe / ose (f) sigurimin ose marrjen e pagesave ose përfitimeve për të siguruar pëlqimin e personit që ushtron kontroll mbi një person tjetër, dhe / ose (g) administrimi i çdo ilaçi ose lënde tjetër që synon të anestezojë ose neutralizojë fuqinë ose rezistencën e tij, dhe / ose (h) borxh fiktiv, është fajtor për një krim dhe nëse dënohet, i nënshtrohet burgimit jo më shumë se njëzet e pesë vjet” dhe, për veprën penale **“Trafikimi i fëmijëve”** neni 10 i tij parashikon: *“Kush rekruton, transferon, transporton, ushqen ose pranon një fëmijë, shkëmben*

ose transferon kontroll mbi atë fëmijë, për qëllim të shfrytëzimit, është fajtor për një krim dhe, në rast dënimi, i nënshtrohet burgimit të përjetshëm.”

Ndërsa, Kodi Penal Shqiptar https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf për veprën penale “**Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit**” neni 109 i tij parashikon se:

“Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit me qëllim për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi, për të ndihmuar fshehjen ose largimin e autorëve ose bashkëpunëtorëve në kryerjen e një krimi, për t’iu shmangur dënimit, për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara, për qëllime politike ose çdo qëllim tjetër, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet. Po kjo vepër e kryer ndaj të miturit nën moshën 14 vjeç dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit ose e të miturit nën moshën 14 vjeç, i paraprirë ose i shoqëruar me tortura fizike ose psikike, kur është kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet dhe, kur është shkaktuar vdekja, me burgim të përjetshëm.”

Shkeljet e rënda të të drejtave themelore, të lirisë dhe dinjitetit kundër këtyre dy shtetaseve shqiptare të kryera nga ana e Nikolas Eleftheriou në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarë dhe funksionarë qipriotë, ku këta të fundit, përmes forcës, abuzimit të pushtetit, përndjekjeve, akteve çnjerëzore, torturës, mashtrimit, falsifikimit dhe kërcënimeve i mbanin peng në tokën qipriote, kishin si qëllim që t’i rrëmbenin fëmijën. Pra, sipas Kodit Penal Shqiptar kemi të bëjmë me konsumimin e veprës penale “**Zhdukja me forcë**” parashikuar nga neni 109/c i tij ku shprehimisht citon se:

“Zhdukja me forcë, nëpërmjet arrestimit, burgimit, rrëmbimit ose çdo forme tjetër heqjeje lirie të personit, nga funksionarët publikë apo nga persona që veprojnë me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e tyre, shoqëruar me mospranimin e faktit të heqjes së lirisë apo me fshehjen e fatit të personit ose vendit në të cilin ndodhet ai, duke i mohuar ndihmën dhe mbrojtjen e nevojshme, sipas ligjit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Eprori që: a) ka dijeni që vartës të vendosur nën autoritetin dhe kontrollin e tij efektiv po kryejnë ose do të kryejnë zhdukje me forcë, ose nuk merr parasysh të dhëna dhe informacione që e tregojnë qartë këtë fakt; b) ushtron përgjegjësinë dhe kontrollin e tij efektiv mbi veprimtarinë me të cilat është lidhur zhdukja me forcë; apo c) nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme që janë në kompetencën e tij për të penguar ose ndëshkuar personin që jep autorizimin, mbështetjen dhe miratimin e zhdukjes me forcë, ose për t’ia dërguar çështjen organeve kompetente të ndjekjes penale, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen, apo shoqërohet me vuajtje të rënda fizike, kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. Kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen e personit, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm. Marrja e paligjshme e fëmijëve që janë subjekt i një zhdukjeje me forcë, ose e fëmijëve, babai, nëna ose përfaqësuesi ligjor i të cilëve është bërë subjekt i një zhdukjeje me forcë, apo e fëmijëve të lindur gjatë periudhës së zhdukjes me forcë, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Neni 110/a i Kodit Penal Shqiptar për figurën e veprës penale **“Trafikimi i personave të rritur”** parashikon se:

“Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo veprë kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.”

Ndërsa, neni 128/b i tij për veprën penale **“Trafikimi i të miturve”** citon shprehimisht:

“Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.”

5. Njohja e paligjshme e atësisë. Dhënia me falsitet e shtetësisë, pasaportës dhe kartës së identitetit qipriot.

ËSHTË PARIM I PËRGJITHSHËM JURIDIK SE, NJË AKT I CILËSUAR ME LIGJ SI ABSOLUTISHT I PAVLEFSHËM NUK MUND TË BËHET I VLEFSHËM. PAVLEFSHMËRIA E NJË AKTI I BËN TË PAVLEFSHME AKTET E MËPASME QË VAREN NGA AI QË ËSHTË DEKLARUAR I PAVLEFSHËM. Nëkuptohe se, çdo veprim apo mosveprim që ka pasuar nga ajo martesë false qipriote, është absolutisht i paligjshëm.

Fëmija e mitur **ELEFThERIA NEÇI** ('Eleftheriou') me datëlindje 26.10.2011 shtetase shqiptare me Nr. Personal L16026075N dhe me Pasaportë shqiptare Nr. BB8530785, e cila që nga lindja është nën kujdesin prindëror të vetëm të nënës së saj znj. Neçi dhe me banim të përhershëm në Shqipëri, në të vërtetë, është viktimë e trafikimit dhe e pengmarrjes nga krimi i organizuar dhe strukturuar ndërkombëtar gjeneruar nga Qipro, që prej ditës që ka lindur. Kjo dëshmohet nga faktet konkrete të mëposhtme:

1) Njohja e atësisë dhe regjistrimi i fëmijës me mbiemrin 'Eleftheriou', kryer pa dijeninë dhe pa konsensusin e nënës së fëmijës, bie në kundërshtim të hapur me Ligjin qipriot **"Për marrëdhëniet Prind dhe Fëmijë"** nr. 216/1990 http://www.cylaw.org/nomoi/enop/non-ind/1990_1_216/full.html që në lidhje me **"Mbiemrin e fëmijës"** neni 3 pika (1) gërma (a) parashikon se: *"Prindërit mund të identifikojnë mbiemrin e fëmijës së tyre me një deklaratë të përbashkët me shkrim"* dhe (b) *"Deklarata e parashikuar në nënparagrafin (1) bëhet përpara regjistruarit të vendit të lindjes së fëmijës brenda tre muajve nga fundi i muajit në të cilin lindi fëmija."* Neni 4 pika (1) gërma (a) për **"Mbiemrin e një fëmije pa martesë të prindërve"** citon shprehimisht se: *"Një fëmijë i lindur pa martesë nga prindërit merr mbiemrin e nënës së tij."* Ndërsa, neni 16 mbi **"Fëmijët pa martesë të prindërve"** parashikon se: *"Përgjegjësia prindërore e fëmijës që lindi dhe mbetet pa martesë të prindërve i takon nënës. Në rast të njohjes, babai gjithashtu merr kujdesin prindëror",* veprime që bien në kundërshtim të hapur edhe me dispozitat e Ligjit shqiptar Nr.9062, datë 8.5.2003 **Kodi i Familjes** http://www.pp.gov.al/web/kodi_i_familjes_22.pdf ku neni 181 i tij mbi **"Njohjen e atësisë"** për fëmijët e lindur pa martesën e prindërve parashikon shprehimisht: *"Atë i fëmijës së lindur jashtë martese është personi madhor që e njeh fëmijën si të tij. Njohja e atësisë është e vlefshme kur për këtë jep pëlqimin nëna e fëmijës, të cilën e lajmëron nëpunësi i gjendjes civile. Kur nëna e kundërshton këtë njohje ose nuk përgjigjet brenda 1 muaji nga marrja e lajmërimit, burri që ka njohur fëmijën si të tij mund të ngrejë padi para gjykatës kompetente për të vërtetuar se ai është i ati i fëmijës. E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti nga data e marrjes së lajmërimit nga nëpunësi i gjendjes civile, për mospranimin nga ana e nënës."*


2) Regjistrimi i foshnjës në Zyrën e Gjendjes Civile në Larnaka kur martesë është false/inekzistente, pa një leje qendrimi të rregullt qipriote, pa një rezidencë në Shtetin Qipriot të nënës të fëmijës si dhe dhënia e shtetësisë qipriote, e pasaportës dhe kartës së identitetit qipriot pa dijeninë dhe pa konsensusin e nënës së fëmijës, janë veprime të kryera në dhunim me dispozitat e ligjit qipriot **"Ligji për Regjistrimin e Popullsisë i vitit 2002 (141 (I) / 2002)"** http://www.cylaw.org/nomoi/enop/non-ind/2002_1_141/full.html

Pra, kryerja e martesës mashtruese/inekzistente qipriote dhe njohja absolutisht e paligjshme e atësisë çojnë në arsyetimin ligjor të pakontestueshëm se, fëmija e mitur Eleftheria automatikisht i takon NËNËS, i takon mbiemri i nënës së saj NEÇI dhe vetëm shtetësia e nënës, ajo SHQIPTARE.

Aktet e gjendjes civile shqiptare të mëposhtme të fëmijës Eleftheria 'Eleftheriou':

a) Çertifikatë Lindje, lëshuar më 16.09.2015 nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë-Shqipëri (**dok. 17**);

DINORA NEÇI



- b) Çertifikatë Lindje lëshuar më 03.07.2017 nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë-Shqipëri me përkthim të noterizuar në gjuhën italiane dhe legalizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë (**dok. nr.18-22**);
- c) Çertifikatë Personale lëshuar më 03.07.2017 nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë-Shqipëri me përkthim të noterizuar në gjuhën italiane dhe angleze dhe legalizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë (**dok. nr.23-31**);
- d) Dy Çertifikatë Lindje, lëshuar më 04.11.2020 dhe më datë 06.11.2020 nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë-Shqipëri (**dok. 32, 33**);
- e) Çertifikatë Familjare, lëshuar më 17.03.2016 nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë-Shqipëri me përkthim të noterizuar në gjuhën greke dhe angleze dhe legalizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë (**dok. nr. 34 -42**);
- f) Çertifikatë Familjare, lëshuar më 03.17.2017 nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë-Shqipëri me përkthim të noterizuar në gjuhën italiane dhe legalizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë (**dok. nr. 43 -51**);
- g) Dy Çertifikatë Familjare, lëshuar më 19.01.2018 dhe më nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë-Shqipëri të legalizuar me vulë Apostillë nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë (**dok. nr. 52 -57**);
- h) Çertifikata Personale të fëmijës dhe Çertifikata Familjare nxjerrë nga sistemi elektronik online i Qeverisë Shqiptare e-Albania nga viti 2018 deri me sot (**dok. nr. 58 - 126**);
- i) Tre Çertifikatë Vendbanimi shqiptare e Kryefamiljares-gjyshes, nënës dhe e fëmijës lëshuar më 09/12/2016 nga Rajoni nr. 3- Bashkia Berat (**dok. 127, 128, 129**),
dëshmojnë se, e mitura rezulton shtetase shqiptare e regjistruar në të njëjtën përbërje familjare me të ëmën Dinora Neçi nën kujdestarinë e saj eskuzive.

Rasti në fjalë, për nga shumëllojshmëria e ngjarjeve të rënda kriminale të provuara me prova të dokumentuara, të ndodhura në këto 10 vite holokaust, paraqitet si një pengmarrje politike e vajzës së mitur Eleftheria që sot është 9 vjeç dhe për këtë flasin vetë faktet.

Kryeministri Shqiptar në cilësinë edhe si Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme z. Edi Rama, i cili prej pesë vitesh është i mirëinformuar me prova dhe fakte të pakundërshtueshme mbi rrëmbimin ndërkombëtar dhe pengmarrjen politike të fëmijës së mitur shqiptare në Republikën e Qipros, në mënyrë të vetëdijshme ka heshtur dhe po vazhdon të heshtë duke bërë që ky krim të vazhdojë të konsumohet që nga 10.11.2015 deri më sot, që janë **2,265 ditë pengmarrje pa asnjë lloj komunikimi me nënën e saj dhe me asnjë familjar tjetër.**

E drejta legjitime si qytetare shqiptare, si NËNË dhe si viktimë e pengmarrjes dhe e trafikimit të qenieve njerëzore ndërkombëtare, për të denoncuar rrëmbimin dhe pengmarrjen ndërkombëtare të fëmijës së saj - duke shërbyer të gjitha elementet e provës materiale të martesës false qipriote si dhe të të gjithë krimeve të rënda të kryera kundër saj dhe kundër jetës dhe shëndetit të vajzës së saj, që sipas nenit 7 te Statutit të Romës kualifikohen si krime kundër njerëzimit - i është mohuar kudo ku ka kërkuar Drejtësi: si nga Policia e Shtetit ashtu edhe nga Interpol/Europol Tirana si dhe nga Autoritetet përgjegjëse Shqiptare. E njëjta 'politikë humane' është ndjekur edhe nga Autoritetet Diplomatike Shqiptare të akredituara në Itali dhe Greqi, të cilat në dijeni të rastit në fjalë, në këto 5 vite kanë manifestuar vetëm heshtje të frikshme dhe pafuqinë/paaftësinë e tyre për të zbatuar

Kushtetutën dhe ligjet e vendit si dhe aktet ndërkombëtare në fuqi për lirin dhe kthimin e të miturës, nënës së saj.

Një dëshmi tjetër e pengmarrjes politike të fëmijës shqiptare janë dokumentet e të mëposhtme të znj. Neçi:

a) Çertifikatat e Gjendjes Penale të lëshuara nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë lëshuar më 27/10/2016 dhe 04/11/2020 (**dok. 130, 131**);

b) Çertifikata e Përgjithshme e Regjistrimit Penal lëshuar nga Sistemi i Informacionit i Ministrisë të Drejtësisë Italiane më 23/09/2016, 24/09/2016 dhe më 03/10/2016 dhe Çertifikata e Ngarkesave Penale me Vulë Apostillë lëshuar nga Sistemi Informativ i Ministrisë të Drejtësisë Italiane më 24/09/2016, më 03/10/2016 dhe më 17/06/2019 (**dok. nr.132 -139**);

c) Çertifikata e Regjistrimit Penal Evropian E.C.R.I.S - SISTEMI INFORMATIV I REGJISTRIT PENAL EVROPIAN – me Vulë Apostillë, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë Italiane më 17/06/2019 (**dok. 140, 141**),

që vërtetojnë GJENDJEN GJYQËSORE ABSOLUTISHT TË PASTËR të znj. Dinora Neçi dhe ulërasin rrëmbimin dhe mbajtjen peng të saj për 7 muaj nëpër burgjet gjermane dhe ato qipriote nën dhunë, tortura dhe aktesh çnjerëzore (me akuzën false dhe absurde se kishte rrëmbyer fëmijën e saj) si dhe rrëmbimin e fëmijës Eleftheria nga një akt terrorist nga ana e Autoriteteve të Drejtësisë Gjermane në bashkëpunim me Autoritetet e Drejtësisë Qipriote.

Të tjera fakte që dëshmojnë implikimin e Policisë së Shtetit Shqiptar si dhe të Institucioneve përgjegjëse shtetërore shqiptare në pengmarrjen politike të fëmijës së mitur shqiptare janë:

d) Të dhënat personale të identifikimit të fëmijës së mitur Eleftheria ‘Eleftheriou’ sipas Sistemit të Informacionit Elektronik të Regjistrimit Civil Kombëtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë, ku, në mënyrë absurde dhe të pabesueshme, rubrikat përkatëse: “Vendlindja, Qyteti i lindjes dhe Nacionaliteti” të së miturës shqiptare rezultojnë të ‘PANJOHUR’, ndërkohë që, rezultojnë Emri i nënës: Dinora, Emri i babait: Nikolas, Numri Personal Identifikues L16026075N dhe Nr. i Pasaportës Shqiptare BB8530785, ndërsa Qyteti i lëshimit të dokumentit është i paplotësuar, nxjerrë më 29.09.2017 (**shih dok. 142, 143, 144, 145**).

Pak kohë më vonë, këto të dhëna personale të fëmijës në Sistemit e Informacionit Elektronik të Regjistrimit Civil Kombëtar të MB të RSh-së, janë ndryshuar. Përkatësisht rubrikat: “Vendlindja, Qyteti i lindjes” ende rezultojnë të ‘PANJOHUR’, ndërsa në rubrikën e Nacionalitetit rezulton të jetë fshirë fjala ‘PANJOHUR’. Ajo që është e dhimbshme, mizore dhe përpos e kundërligjshme dhe kundër natyrës, është fakti se, në këto të dhëna është fshirë rubrika dhe emri i nënës së fëmijës duke mbetur të pandryshuara të dhënat: Emri i babait: Nikolas, Numri Personal Identifikues L16026075N, Nr. i Pasaportës Shqiptare BB8530785 dhe Qyteti i lëshimit të dokumentit i paplotësuar (**shih dok. 146**).

Kërkesës së znj. Dinora Neçi datë 02/04/2020 drejtuar me e-mail z.Andi Likaj - Shef i Zyrës Qendrore Kombëtare të Interpol Tirana pranë Policisë së Shtetit, për lëshimin e kopjes së Pasaportës shqiptare të vajzës Nr. BB8530785, (të cilën, funksionarët e Policisë gjermane ia vodhën ditën që i rrëmbyen dhe vajzën, duke ia dhënë Nikolas Eleftheriou në mënyrë që, mos të kishte se si të dokumentonte shtetësinë shqiptare të fëmijës së saj), i pasoi një përgjigje e-mail

anonime nga ZQK e Interpol-Tirana, me anë të së cilës i komunikohen të njëjtat të dhëna personale të identifikimit të vajzës (Vendlindja dhe Qyteti i lindjes të 'PANJOHUR'; Nacionaliteti i paplotësuar; rubrika dhe emri i nënës së fëmijës i fshirë) të nxjerra nga Sistemi TIMS (Total Information Management System) i Policisë së Shtetit (**dok. 147, 148, 149, 150**). Këto dokumente vërtetojnë se kemi të bëjmë me konsumimin e veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186 dhe "Falsifikimi kompjuterik" sipas neni 186/a të K.P.

e) Apelit të mëtejshëm të znj. Neçi të datës 12 nëntor 2019 drejtuar sërish **instancave më të larta të Shtetit Shqiptar**, të cilët duhet të kishin parashikuar lirimin e menjëhershëm dhe kthimin e të miturës shqiptare, nënës saj, i pasoi një tjetër heshtje shurdhuese (**dok. 151-174**).

f) Aplikimi i nënës Dinora nëpërmjet Platformës online SHKO në Portalin e-albania për Shtetasit e humbur me kod aplikimi 0102BA191030DINE2526347, pasi shërbeu dokumentacionin e nevojshëm për kthimin e vajzës së saj, prej datës 6 nëntor 2019 deri më sot rezultoi se "Aplikimi me kod '0102BA191030DINE2526347' po shqyrtohet nga personat përgjegjës" pa asnjë veprim aktiv nga autoritetet përgjegjëse shqiptare. (**dok. 175, 176, 177, 178**).

g) Si përgjigje të kërkesës së zonjës Neçi, për informacion mbi Aplikimin për Shtetasit e humbur Nr.0102BA191030DINE2526347 drejtuar me e-mail z. Andi Likaj - Shef i Zyrës Qëndrore Kombëtare të Interpol TIRANA (**dok. 179**), kjo nënë, merr përsëri një e-mail anonim nga Zyra Qendrore Kombëtare e Interpol Tirana (**dok.180**), përmbajtja e së cilës është si vijon:

"Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Zyrës Qendrore të Interpol Tirana nga verifikimet e kryera nga ana jonë me komunikimin direkt me Interpol Nicosia, ju informojmë se, në lidhje me kërkesën e shtruar nga ana jonë ka patur një vendim gjyqësor të autoriteteve Qipriote në lidhje me dhënien e kujdestarisë së fëmijës babait të saj biologjik. Autoritetet Qipriote na njoftojnë se, nga ana e gjykatës ka pasur një njoftim zyrtar për Znj.Dinora Neci për të marrë pjesë në seancën gjyqësore për dhënien e kujdestarisë së fëmijës por Znj.Neci nuk është paraqitur në këtë seancë gjyqësore, pamvarsisht se Akt-Vendimi i kësaj Gjykate ishte para çështjes së rrëmbimit të fëmijës për të cilin kjo zonjë u shpall në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet Qipriote. Përfundimisht fëmija është në gjendje të mirë shëndetësore pasi iu dorëzua babait nga Autoritetet Gjermane dhe u kthye në Qipro ku ndodhet aktualisht. Nga Policia në lidhje me këtë çështje nuk ka informacion tjetër. Znj.Neci, Lutemi që për të vazhduar procedurat e tjera ndiqni rrugët institucionale ligjore përgjegjëse në lidhje me këtë rast (komunikimin me autoritetet konsullore ose rrugën gjyqësore nëpërmjet avokatit tuaj). Pamvarsisht ndjeshmërisë njerëzore që kjo çështje paraqet për të gjithë ne, ju bëjmë me dije se Interpol Tirana e ka të pamundur nga ana ligjore ndjekjen e saj, pasi nuk futet në kompetencat e kësaj zyre. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, NCB Interpol Tirana".

Së pari, përgjigja e funksionarit të paidentifikuar i Zyrës Qendrore Kombëtare Interpol Tirana është në shkelje të hapur me parimet kushtetuese të transparencës, paanësisë dhe me parimet e Shtetit të së drejtës.

Së dyti, Policia e Shtetit si institucion ligjzbatues dhe ZQK Interpol Tirana, kanë detyrim kushtetues, ligjor dhe nga aktet ndërkombëtare, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parandalojnë, zbulojnë dhe hetojnë, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre. Ndërsa rastin e fëmijës së mitur

shqiptare, e kanë trajtuar me neglizhencë të rëndë dhe të qëllimshme, duke mos ndërmarrë asnjë veprim hetimor në lidhje me denoncimin e saj të bazuar në prova të dokumentuara.

Së treti, Policia e Shtetit ka detyrimin dhe përgjegjësitë përmes mjeteve dhe mekanizmave ligjorë për të kryer kontrollet e nevojshme mbi të dhënat personale të shtetasve përmes Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe Adresarit, përmes Regjistrin Themeltar Gjyqësor dhe Regjistrin elektronik Gjyqësor. Fakti që, ZQK e Interpol Tirana, është përgjigjur në rrugë anonime se ‘*vajza ndodhet në Qipro me babain e saj në bazë një vendimi gjyqësor të autoriteteve Qipriote*’ duke e konsideruar këtë nënë si “*rrëmbyese të fëmijës të saj*” dhe “*të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet Qipriote*”, kur aktet e gjendjes civile shqiptare të zonjës Neçi dhe të fëmijës së saj provojnë mosekzistencën e martesës civile qipriote, shtetësinë shqiptare të fëmijës Eleftheria me banim të përhershëm në Shqipëri dhe nën kujdestarinë prindërore eskuzive të nënës dhe, kur është e provuar gjendja gjyqësore “E PASTËR” e zonjës Neçi nga certifikatat e lëshuara nga Autoritetet e Drejtësisë Shqiptare, nga Autoritetet e Drejtësisë Italiane dhe nga Sistemi i Regjistrin Informativ Penal Evropian (E.C.R.I.S), dëshmojnë qartë se Autoritetet e Policisë Shqiptare janë të implikuar në çështjen e mbajtjes peng të fëmijës së mitur shqiptare në tokën qipriote.

h) Këtë e dëshmon haptazi edhe fakti se, kërkesës së mëtejshme të nënës së fëmijës drejtuar me e-mail z. Andi Likaj - Shef i Zyrës Qëndrore Kombëtare të Interpol Tirana, duke i kërkuar informacione më të hollësishme mbi mbajtjen e fëmijës së saj në tokën qipriote, përmbajtja e së cilës është si mëposhtë vijon:

“Duke marrë shkas nga përgjigjia juaj, si NËNË me të drejtën e kujdestarisë prindërore të vetme mbi fëmijën tim të mitur Eleftheria Eleftheriou shtetase shqiptare, KËRKOJ, të më jepni informacione më të hollësishme mbi mbajtjen e fëmijës tim në tokën qipriote në lidhje me pikat e mëposhtme: 1) A është i sigurt Autoriteti i Interpol Nikosia nëse egziston ky Akt-vendim gjykate mbi kujdestarinë e vajzës sime? 2) A i është përcjellë nga gjykata (cila gjykatë?) një vendim i tillë dhe a e kanë lexuar atë? 3) A ju kanë komunikuar Interpol Nikosia një vendim të tillë? Një deklaratë e tillë (siç e përshkruani ju) e paraqitur nga ana e Interpol Nikosia që pretendon se egziston një vendim gjykate në lidhje me këtë çështje kaq delikate dhe me një ndjeshmëri të lartë njerëzore (ju rikujtoj se vajza ime më është rrëmbyer në mënyrën më makabre e të paimagjinueshme më 10 nëntor 2015 dhe që deri më sot, nuk ka patur asnjë lloj kontakti me mua, nënën e saj), DUHET TË JETË E BAZUAR NË FAKTE. Prandaj, duke u bazuar në ligjin nr. 119/2014 neni 3 mbi të drejtën e informimit dhe të transparencës, si palë direkte e interesuar, ju lutem të më komunikoni një kopje të përgjigjes që ju është përcjellë nga ana e Interpol Nikosia dhe një kopje të këtij vendimi, nëse ka. Ju garantoj, se deri më sot, mua si nënë e fëmijës nuk më është komunikuar asnjë njoftim zyrtar dhe asnjë vendim lidhur me çështjen e vajzës sime sepse nëse do egzistonte një vendim i tillë atëherë do të më ishte komunikuar në rrugë zyrtare. Në pritje të një përgjigjes suaj sa më shpejt të jetë e mundur. Faleminderit!”, **PASOI NJË HESHTJE ABSOLUTE (dok. 181);**

i) Për apelin e saj me datë 12.11.2019 drejtuar edhe Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë, znj.**Erinda Ballanca**, ku kërkon ndërhyrjen e saj tek Autoritetet përgjegjëse shqiptare për lirim nga pengmarrja qipriote dhe kthimin e fëmijës së saj, kjo nënë merr një përgjigje hapurazi tallëse ndaj të drejtave të saj, vetëm pas një viti (!) përmes e-mailit, saktësisht, me datë 16.11.2020 nga Komisionerja e këtij institucioni znj.**Ermonela Ruspi (dok.**

182, 183, 184). Një përgjigje, në mënyrë të qëllimshme të paligjshme dhe diskriminuese, në favorizim të pengmarrësve të së miturës shqiptare, sikurse ajo e funksionarit anonim të Zyrës Qëndrore Kombëtare të Interpol Tirana. Në të njëjtën mënyrë edhe znj. Ruspi, injoron odisenë 10-vjeçare ndërkombëtare me fakte dhe prova të dokumentuara tronditëse të shërbyera nga nëna e fëmijës, që dëshmojnë krimet e rënda kryer kundër saj dhe vajzës së saj të mitur. Dhe jo vetëm! Përmes mashtrimit, përpiqet ta bindë këtë NËNË, se është ajo ‘rrëmbyese e fëmijës’ dhe për këtë ‘fakt’ paska qënë edhe ‘e shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Autoritetet Qipriote’ kur është e provuar se zonja Dinora Neçi është nëna biologjike e fëmijës shqiptare Eleftheria ‘Eleftheriou’ dhe ka kujdestarinë dhe përgjegjësinë prindërore eskuzive ndaj së miturës.

Gjithashtu, Komisionerja Ruspi, në mënyrë të paturpshme dhe e zhveshur nga çdo ndjenjë njerëzore, nga çdo parim kushtetues dhe ligjor, ‘legjitimon’ shkeljet e rënda ndaj të drejtave dhe lirive themelore të nënës dhe fëmijës së saj shtetase shqiptare nga ana e Institucioneve përgjegjëse Shqiptare. Përpos kësaj, znj. Ruspi, e vetëdijshme se NUK EGZISTON asnjë vendim gjyqësor shqiptar apo qipriote, i cili të bëjë fjalë për ndarjen e nënës nga fëmija dhe që të ketë marrë fuqi në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet njohjes së tij, pasi është e provuar me prova të pakundërshtueshme, siç janë aktet e gjendjes civile shqiptare dhe çertifikatat e gjendjes gjyqësore të shërbyer nga znj. Neçi që dëshmojnë mosegzistencën e martesës qipriote dhe ulërasin rrëmbimin dhe pengamrrjen e fëmijës, përmes gjuhës së mashtrimit, kërkon ta bindë nënën-viktimën e holokaustit, se vajza e saj ndodhet në Qipro mbi bazën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Beratit, që sipas saj, paska caktuar kujdestarinë e fëmijës, babait biologjik.

Poashtu, kjo komisionere anti kushtetuese dhe antiligj, i sugjeron nënës së fëmijës që t’i kërkojë të drejtat e saj duke pajtuar një avokat, me qëllim rihapjen e procedurave gjyqësore në shtetin ku gjendet e mitura shqiptare, në Qipro! Znj. Ruspi është kontradiktore në përgjigjen e saj, pasi vetë ajo, i referohet akteve të gjendjes civile shqiptare, ku e mitura rezulton e regjistruar në të njëjtën përbërje familjare me të ëmën Dinora Neçi nën kujdestarinë e saj eskuzive dhe banore e përhershme në Shqipëri. Nuk ekziston një ligj që të parashikojë se një shtetas mund të jetë banor i përhershëm në dy shtete të ndryshme. Pra, edhe përgjigja e komisioneres Ermonela Ruspi dëshmon edhe njëherë se, mbajtja peng e së miturës shqiptare Eleftheria ‘Eleftheriou’ në Qipro është **PENGMARRJE POLITIKE - KRIM I ORGANIZUAR NDËRSHTETËROR.**

Pra, jemi përballë një krimi makabër, ai i rrëmbimit dhe mbajtjes peng në tokën qipriote i fëmijës së mitur shtetase shqiptare Eleftheria ‘Eleftheriou’ që prej 5 vitesh vazhdon të konsumohet, vepër penale e cilësuar sipas nenit 1 të Konventës Ndërkombëtare të Nju Jorkut **“Kundër marrjes së pengjeve”** të 18 dhjetorit 1979;

Çështja në fjalë karakterizohet nga elementë të figurës së veprave penale të rënda kundër lirisë personale të së miturës shqiptare Eleftheria që janë duke u konsumuar, të cilat sipas Kodit Penal Shqiptar janë: a) “Rrëmbimi dhe pengmarrja e personit” neni 109; b) “Zhdukja me forcë” neni 109/c dhe c) “Trafikimi i të miturve” neni 128/b.

Ndërsa, në Kodin Penal Qipriot (KAP 105), veprat penale kundër lirisë së personit të mitur parashikohen në nenet vijuese:

- a) Neni 185 **“Vjedhje e fëmijës”**: *“Kushdo që ka për qëllim të privojë nga prindi, kujdestari ose personi tjetër që ka kujdesin ligjor ose kujdestarinë e një fëmije nën*

moshën katërmbëdhjetë vjeç nga posedimi i një fëmije të tillë;(a) heq me forcë ose me mashtrim ose josh fëmijën për ta ndjekur ose ndaluar atë ose atë; ose (b) ndërsa është në dijeni të sa më sipër, pranon ose i jep azil një fëmije; është fajtor për një krim dhe përballet me shtatë vjet burg. Ndjekja penale e të pandehurit për çdo vepër penale të përcaktuar në këtë nen është provë se personi i akuzuar pretendoi me mirëbesim të drejtën për të pasur fëmijën ose, në rastin e një fëmije të paligjshëm, se ishte nëna e tij ose që ai pretendonte atësinë e fëmijës”;

b) Neni 246 **“Përkufizimi i rrëmbimit nga kujdestaria ligjore”**: *“Kushdo që largon ose tërheq një të mitur nën moshën katërmbëdhjetë vjeç në rastin e një burri, ose nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç në rastin e një gruaje ose një personi i cili është i shqetësuar në mënyrë të arsyeshme, nga kujdestaria e kujdestarit të tij ligjor, pa miratimin e një kujdestari të tillë, konsiderohet se rrëmben të miturin ose personin e tillë nga kujdestari i tij ligjor”;*

c) Neni 247 **“Përkufizimi i rrëmbimit”**: *“Kushdo që me forcë ose me ndonjë mjet mashtrues motivon një tjetër për të lënë një vend, konsiderohet se ka rrëmbyer personin në fjalë”;*

d) Neni 248 **“Dënimi i rrëmbimit”**: *“Kushdo që rrëmben një person nga Republika ose nga kujdestaria ligjore, është fajtor për një krim të rëndë dhe i nënshtrohet dënimit me shtatë vjet burgim dhe një gjobë”;*

e) Neni 10 **“Trafikim i të miturve”** sipas ligjit qipriot **“Për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit dhe Shfrytëzimit të Personave dhe Mbrojtjen e Viktimave të vitit 2014 (60 (I) / 2014)”** që parashikon se: *“Kush rekruton, transferon, transporton, ushqen ose pranon një fëmijë, shkëmben ose transferon kontroll mbi atë fëmijë, për qëllim të shfrytëzimit, është fajtor për një krim dhe, në rast dënimi, i nënshtrohet burgimit të përjetshëm.”*

Cilësohet fakti se, qiprioti Nikolas Eleftheriou klasifikohet tek personat me agresivitet dhe rrezikshmëri të lartë shoqërore në drejtim të jetës dhe shendetit të së miturës Eleftheria. Theksojmë gjithashtu faktin se, ky subjekt kriminal ndërkombëtar edhe në të shkuarën ka shënuar ngjarje të tilla konkrete, ku ka tentuar të vrasë nënën dhe foshnjën e saj. Dhe, të mos harrohet kurrësesi fakti emblemantik se, falë kësaj Nëne Heroinë znj. Dinora Neçi, e cila mbrojti me dhemb e me thonj fëmijën e saj nga tentativa e abortit, sot, pengmarrësi Eleftheriou, gëzon titullin – baba biologjik!!

Theksohet në veçanti se, mos zbatimi i legjislacionit vendas në fuqi dhe atij ndërkombëtar, edhe pse ratifikuar Statuti i Romës dhe i Konventave në lidhje me çështjen në fjalë, jo vetëm nga institucionet përgjegjëse shqiptare dhe ato qipriote por edhe nga të gjithë avokatët, të cilëve zonja Neçi i është drejtuar në këto pesë (5) vite, duke kërkuar ndihmë për lirim e vajzës së saj nga pengmarrja qipriote, si dhe, censurimi i rastit nga një numër i konsiderueshëm gazetarësh dhe media të ndryshme, të cilëve kjo nënë u ka kërkuar dëshpërimisht ndihmë për bërjen publike të tij që nga koha e mbajtjes peng (nënë dhe foshnje e porsalindur) në tokën qipriote, ka bërë që historia në fjalë, të marrë përmasa gjigante, duke u shtrirë në 6 vende evropiane, ku janë të përfshirë policë, funksionarë gjyqësorë dhe nënpunës publikë si dhe avokatë, duke vepruar si një strukturë e organizuar kriminale ndërkombëtare në interes të familjes mafioze qipriote Eleftheriou dhe / ose të atyre që fshihen pas saj dhe duke kryer çdo akt dhe veprim çnjerëzor kundër nënës së re shqiptare

Dinora Neçi me qëllimin e vetëm mizor: rrëmbimin e vajzës së saj të vogël Eleftheria dhe mohimin e çdo kontakti ose komunikimi midis nënës dhe vajzës.

Një KRIM i paparë dhe i padëgjuar në historinë e re të njerëzimit:

Holokausti Multi-Shtetesh kundër një nëne dhe fëmijës së saj të mitur shtetase shqiptare!!

Për shkak të këtyre peripecive, NËNA SHQIPTARE u detyrua të studionte vetë legjislacionin e brendshëm shqiptar dhe qipriot si dhe atë ndërkombëtar në lidhje me çështjen e vajzës së saj, për të arritur në arsyetimin ligjor dhe të padiskutueshëm që, mosekzistenca e asaj martesë false qipriote konstaton rrëmbimin dhe mbajtjen peng të fëmijës së saj që nga lindja, në tokën qipriote.

Theksohet se, në përputhje me legjislacionin penal shqiptar dhe me të Drejtën Penale Ndërkombëtare, çështja do të silllet në vëmendjen e Gjykatave Kompetente Ndërkombëtare dhe të gjitha mediave ndërkombëtare, për të siguruar që e vogla Eleftheria të lirohet menjëherë dhe t'i kthehet nënës së saj.

Prandaj, Autoritetet kompetente të Shtetit Shqiptar duhet të veprojnë menjëherë pa humbur kohë, për t'i dhënë fund kësaj odiseje të gjatë 10-vjeçare të historisë kriminale të pengmarrjes së Eleftheria të bazuar në fakte, prova dhe dëshmitarë, duke marrë masa urgjente për të realizuar lirimin nga kthetrat e familjes mafioze qipriote të fëmijës së mitur shqiptare dhe kthimin e saj pranë nënës, në mënyrë që të parandalohen pasojat e parikuperueshme, pasi, pasiviteti i Shtetit Shqiptar deri sot, ka inkurajuar dhe po stimulon pengmarrësit e së miturës shqiptare.

Edhe njëherë, përmes kësaj letre i bëhet thirrje publike Kryeministrit z. Edi Rama, drejtuesve më të lartë të Policisë së Shtetit, të Interpol dhe Europol Tirana, të Prokurorisë së Përgjithshme, të Institucioneve përgjegjëse të Shtetit Shqiptar dhe Autoriteteve Diplomatike dhe Konsullore Shqiptare të akredituara në Itali dhe në Greqi që të zbatojnë me përpikmëri:

- Kushtetutën e vendit;
- Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë neni 7/a dhe në vijim;
- Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara e 10 dhjetorit 1948;
- Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (C.E.D.U) e 4 nëntorit 1950 e ratifikuar nga Shqipëria më 31 korrik 1996 me ligjin nr. 8137 dhe nga Qiproja më 24 maj 1962 me ligjin nr. 39/1962;
- Konventën e KB për të Drejtat e Fëmijëve e 20 nëntorit 1989 e ratifikuar nga Shqipëria në 11 Dhjetor 1991 me ligjin nr. 7531 dhe nga Qipro më 28 dhjetor 1990 me ligjin nr. 243/1990;
- Konventën e KB për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW) e 18 Dhjetorit 1979 e ratifikuar nga Shqipëria më 9 Nëntor 1993 me ligjin Nr. 7767 dhe nga Qiproja më 12 qershor 1985 me ligjin nr. 78/1985;
- Statutin e Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare i 17 korrikut 1998 i ratifikuar nga Shqipëria në 23 Dhjetor 2002 me ligjin nr. 8984 dhe nga Qiproja më 11 mars 2002 me ligjin nr. 8 (III) / 2002;

- Konventën Ndërkombëtare e Nju Jorkut “Kundër marrjes së pengjeve” të 18 dhjetorit 1979 e ratifikuar nga Shqipëria më 22 nëntor 2001 me Ligjin Nr. 8837 dhe nga Qiproja më 28 dhjetor 1990 me ligjin nr. 244 (I) 1990;
- Ligj nr.8920, datë 11.7.2002 Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj;
- LIGJ Nr.9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”;
- Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,

dhe aktet e tjera ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe legjislacionin në fuqi, dhe të vënë në levizje të menjëhershme të gjitha hallkat dhe mekanizmat shtetërorë të nevojshëm që shërbejnë për kthimin e menjëhershëm të fëmijës së mitur Eleftheria ‘Eleftheriou’ shtetase shqiptare, nënës së saj Dinora Neçi duke garantuar për to të drejtën e mbrojtjes ligjore falas nga Shteti si dhe, hetimin e çështjes nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, ndjekjen penale dhe vënien përpara Drejtësisë të shtetasit grek-qipriot Nikolas Eleftheriou dhe autorëve të tjerë përgjegjës për krimet e rënda kryer kundër nënës dhe fëmijës shqiptare.

Gjithashtu, kërkohet lëshimi i dokumentit ndërkombëtar të udhëtimit “Lascia Passare” nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Romë, si autoritet territorialisht kompetent për kthimin e fëmijës, ndryshimin e të dhënave identifikuese të së miturës sipas ligjit dhe lëshimin e dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen e saj me pasaportë biometrike shqiptare.

Lutemi edhe njëherë, që massmediat dhe mediat dixhitale shqiptare dhe ndërkombëtare të ndihmojnë në ndërkombëtarizimin e çështjes përmes bërjes publike të saj në mënyrë që të marrë fund pengmarrja 9-vjeçare e vogëlushes shqiptare.

Rikthejini fëmijës Eleftheria – LIRINË ashtu sikurse ka dhe emrin.

Ndihmoni këtë NËNË të përqafojë sërish FËMIJËN E SAJ, që Eleftheria të thërrasë përsëri MAMI.

Bashkëlidhur këtij shkrimi gjeni 184 (njëqind e tetëdhjetë e katër) dokumentat që dëshmojnë pengmarrjen e fëmijës shqiptare dhe të cilat mund të konstatohen sipas detyrës zyrtare nga Autoritetet kompetente Shqiptare.

Në pritje të një përgjigjeje të menjëhershme dhe efektive Tuajën.

Tel: 0039 3277 798 254


E-mail.: dinora.neci@yahoo.com

KËRKUESE

E ËMA E TË MITURËS ELEFThERIA ‘ELEFThERIOU’

DINORA NEÇI

(Viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore
dhe e pengmarrjes ndërkombëtare)



DINORA NEÇI

